

 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	51-02	Nr.Prot: Broj.Prot: Prot.No	7786-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-06-	Data: Datum: Date	10.04.26
PRISHTINË/A			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	03.04.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	25/7786/660/DMM
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Ke Luani" Sh.p.k Pejë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/7786/660/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në draft vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Ke Luani" Sh.p.k Pejë, për Impiant për prodhimin e betonit në Pejë.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Kompania "Ke Luani" Sh.p.k Pejë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Impiantin për prodhimin e betonit në ngastrën kadastrale Nr. P-71611071-05625-12 dhe P-71611071-05625-12 në Pejë nën kushtet si vijon:

**I. KUSHTET PËR FAZËN E NDËRTIMIT**

Gjatë ndërtimit të impiantit duhet të sigurohen:

- Sisteme për kontrollin e pluhurit dhe grimcave gjatë transportit dhe shkarkimit të materialeve (rërë, zhavorr, çimento).
- Spërkatje periodike e zonave të hapura me ujë për reduktimin e pluhurit, sidomos gjatë stinëve të thata.
- Rruga e brendshme e transportit të jetë e shtruar dhe e pastruar rregullisht për të shmangur shpërndarjen e materialeve ndërtimore.



Faqe 2 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)

- Instalimi i filtrave dhe aspiratorëve në sistemet e përzierjes dhe ngarkimit për të ulur emetimet e pluhurit.
- Ndalohet derdhja e mbetjeve të ndërtimit në hapësira të paautorizuara.
- Punimet duhet të realizohen brenda orarit të lejuar nga komuna për të shmangur tejkalimin e nivelit të zhurmës.

## II. KUSHTET PËR FAZËN E OPERIMIT

### 1. Menaxhimi i ndotjes së ajrit


- Të gjitha njësitë për përzierje, tharje dhe transport të materialeve pluhurore duhet të jenë të mbyllura dhe të pajisura me filtra industrialë (filtra qelize ose ciklonikë) për të minimizuar pluhurin.
- Magazinimi i çimentos duhet të bëhet në silos të mbyllur hermetikisht, të pajisur me sistem aspirimi dhe filtra pluhuri.
- Pikat e shkarkimit dhe ngarkimit të materialeve duhet të jenë të mbuluara dhe të spërkatura me ujë për kontroll të pluhurit.
- Emetimet e pluhurit nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për normat e cilësisë së ajrit.

### 2. Menaxhimi i ujërave

- Ujërat e ndotura nga procesi i larjes së makinerive dhe transportuesve duhet të mbledhen në gropa sedimentimi dhe të ri-përdoren në procesin e prodhimit kur është e mundur.
- Ujërat e shiut që rrjedhin në zonat e ndotura (me pluhur ose mbetje betoni) duhet të kalojnë në sistem filtrimi para shkarkimit në tokë ose kanalizim.
- Nuk lejohet derdhja direkte e mbetjeve të betonit ose ujërave me mbetje çimentoje në kanalizime ose ujëra sipërfaqësore.

### 3. Menaxhimi i mbeturinave

- Të gjitha mbeturinat e ngurta (beton i tharë, mbetje inerte, çimento e dëmtuar, qese, paleta, mbeturinat metalike) duhet të grumbullohen dhe dorëzohen operatorëve të licencuar për menaxhimin e mbeturinave.
- Mbeturinat e rrezikshme (vajra, lubrifikantë, bateri) duhet të ruhen në enë të veçanta, të mbyllura dhe të etiketuar sipas Udhëzimit Administrativ për Administrimin e Mbeturinave të Rrezikshme.



- OE është i detyruar të mbajë regjistër për llojin, sasinë dhe destinacionin e mbeturinave, dhe ta raportojë atë çdo vit në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

#### 4. Kontrolli i zhurmës dhe dridhjeve

- Pajisjet dhe makineritë duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të pajisura me amortizues zhurme.
- Nivelet e zhurmës në kufirin e parcelës nuk duhet të tejkalojnë vlerat e lejuara.

#### 5. Ruajtja e tokës dhe peizazhit

- Sipërfaqet e tokës që nuk përdoren për prodhim duhet të gjelbërohen me bimësi vendore për të reduktuar erozionin dhe pluhurin.
- Ndalohet ruajtja e materialeve (rërë, zhavorr, mbetje betoni) jashtë perimetrit të objektit.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

### III. PAS PËRFUNDIMIT TË OPERIMIT

1. Çmontimi i të gjitha pajisjeve të prodhimit të betonit (silos, miksera, shirit transportues, sisteme të dozimit).
2. Largimi i mbetjeve të betonit dhe materialeve inerte.
3. Vendosja e tokës vegetative në zonat e degraduara.
4. Rimodelimi i terrenit sipas topografisë natyrore.
5. Mbjellje e gjelbërimit, nëse zona ishte me gjelbërim para aktivitetit.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

### A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Ke Luani" Sh.p.k. Pejë për Pëlqim Mjedisor për Impiantin për prodhimin e betonit në ngastrat kadastrale P-71611071-05625-12 dhe P-71611071-05625-12 në Z.K. Pejë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.



Pëlqimi Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

### **Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Pëlqimi Mjedisor vlen dy vite konform paragrafit 1 të nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

*(Vlefshmëria e pëlqimit mjedisor ndërpritet nëse brenda dy (2) vitesh nga data e pranimit të vendimit për pëlqimin mjedisor: 1.1. Aplikuesi nuk siguron lejen për ndërtim ose aprovimin për realizimin e projektit; dhe 1.2. Lokacioni ku projekti duhet realizuar nuk është përgatitur e as nuk është nisur ndonjë aktivitetet operativ).*

Vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/7786/ ZSP/ /25 datë: 03.04.2026

Prishtinë



T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Pejës
7. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
8. Divizionit për komunikim me publikun
9. Arkivit të MMPHI

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

2. SHTOICË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

